
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p> <p style="color: blue; font-size: 1.2em;">01-1287</p>	
---	--	---

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 & 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, dt. 21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 dhe nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391 dt. 25.02.2010, UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe duke vendosur sipas kërkesës për kushte ndërtimore 05nr.350/02 – 0141344/18 dt. 13.06.2018, të pronarëve, Suat Berisha, Ajet, Avdulla dhe Lulzim Krasniqi, Maliq Buzuku nga Prishtina, Lagjja “Mati 1”, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam.”1” ÷ “5”, në kuadër të parcelës ndërtimore të Ngastra e ndërtimit “L”, Blloku urban “B16” të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit në procedurë administrative me datë 01.10.2018 merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore pronarëve, Suat Berisha, Ajet, Avdulla dhe Lulzim Krasniqi, Maliq Buzuku nga Prishtina, Lagjja “Mati 1”, sipas kërkesës 05nr.350/02 – 0141344/18 dt. 13.06.2018, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleks me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam.”1” ÷ “5”, në kuadër të Ngastra e ndërtimit “L”, Bllokut urban “B16”, të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale, nr.588-2, 588-3, 588-5 & 588-6 ZK Matičan.

II. Lokacioni për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet dhe trajtohet sipas:

- Planit Rregullues “Mati 1”, miratuar me Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues “Mati 1” të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 35-642 dt. 01.04.2010 dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues “Mati 1” të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 031-1678 dt. 20.07.2011, ku sipas këtij plani kjo zonë është e paraparë të jetë “Ndërtim i lartë”;

Pronarët për kriteret, parametrat urban dhe kushtet e ndërtimit, janë informuar përmes “Informim nga Plani Rregullues Mati 1 – PZHU” me referencë 04nr.350/01 – 104228/18 dt. 17.05.2018, të lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit / parcelës kadastrale, nr.588-2, 588-3, 588-5 & 588-6 ZK Matičan, sipas gjendjes kadastrale, pronësore, faktike & planifikimit urban është:

- Numri, sipërfaqja, pronari & klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:

- nr. 588-2;	S=277m ² ;	Ajet Krasniqi, Maliq Buzuku;	“Rrugë private”;
- nr. 588-3;	S=5077m ² ;	Avdulla Krasniqi, Lulzim Krasniqi;	“Arë e klasit 5”;
- nr. 588-5;	S=1959m ² ;	Ajet Krasniqi, Maliq Buzuku;	“Arë e klasit 3”;
- nr. 588-6;	S=2500m ² ;	Suat Berisha;	“Arë e klasit 3”;

Totali : S=9813m².

- E drejta pronësore - juridike e parcelave kadastrale të lartcekura , është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelave kadastrale të lartë cekura, nuk ka ndërtime të ndërtuara;
- Terreni ka pjerrtësi /disnivel nga drejtimi veri kah jugu , me disnivel ~7.0m;

- Qasja ekzistues e parcelave të lartcekur është përmes rrugëve lokale lidhen me rrugët e planifikuara të planit rregullues;
- Parcela kadastrale, nr.588-3 ZK Matiçan, pjesërisht përfshihet në Planit Rregullues "Mati 1" dhe pjesërisht në Plani Rregullues i Hollësishëm për Blloqet, B17, B18, B18 dhe B20-Lagjja "Mati 1" 2017-2025;
- Parcela kadastrale, nr.588-5 ZK Matiçan, bazuar në Certifikatë e njësisë kadastrale është e ngarkuar në hipotekë, për të cilën pronari i sajë Maliq Buzuku, ka siguruar pëlqim për ndërtim në kuadër të kësaj parcele nga Banka Kombëtare Tregtare-BKT me nr.40524 dt.05.07.2018;
- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50 m` nuk ka ndërtesa ekzistuese të ndërtuara bazuar në fotot e lokacionit dhe gjendjes ekzistuese të prezantuar sipas incizimit gjeodezik të gjendjes faktike, nga gjeometri i licencuar Ferid Ahmeti nga Prishtina me numër të licencës 174.

IV. Kushtet ndërtimore përcaktohen për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar në kuadër të parcelës ndërtimore të Ngastra e ndërtimit "L", Blloku urban "B16" të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, dhe bazuar në parametrat, kriteret urban kushtet për ndërtim për realizimin - ndërtimin e kompleksi me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam."1" ÷ "5" dhe hapësira përcjellëse, janë:

- Organizimi & qasja në kompleks, pozicionimi, gabaritet, etazhiteti i ndërtesave, raporti i ndërtesave me vijën rregulluese & ndërtimore, si dhe me distanca nga kufiri i parcelës, rrugët dhe vend parkingjet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit - "zgjidhja urbane" bashkangjitura vendimit kushteve ndërtimore;
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të Kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste - Lam."1" ÷ "5", të Ngastra e ndërtimit "L", Blloku urban "B16", planifikohet të ndërtohet kompleksi me ndërtesa shumë banesore & afariste, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

Kompleksi me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam."1" ÷ "5" ;

Lam. "1" - S=4090m² /3250m², mbi tokë + 840m², nën tokë /,

Etazhitet: -2B+P+7+Ph,

Lam. "2" - S=4090m² /3250m², mbi tokë + 840m², nën tokë /,

Etazhitet: -2B+P+7+Ph,

Lam. "3" - S=3746.80m² / 2906.80m², mbi tokë + 840m², nën tokë /,

Etazhitet: -2B+P+6 ,

Lam. "4" - S=3746m² / 2906.80m², mbi tokë + 840m², nën tokë /,

Etazhitet: -2B+P+7,

Lam. "5" - S=5673.40m² / 4313.40m², mbi tokë + 1360m², nën tokë /,

Etazhitet: -2B+P+5+Ph,

Totali: 1, 2, 3, 4 & 5 – S=21347m² / 16627m², mbi tokë + 4720m², nën tokë/

- Pjesët & parcelat kadastrale për realizimin e Kompleksi me ndërtesa shumë banesore & afariste, të trajtuara brenda vijës rregulluese, janë:

- nr. 588-2; S=266m²;

- nr. 588-3; S=1649m²;

- nr. 588-5; S=1915m²;

- nr. 588-6; S=2500m²;

Totale: S=6330m²;

- Pjesët e parcelës kadastrale për realizimin e Kompleksi me ndërtesa shumë banesore & afariste, të trajtuara jashtë rregulluese, janë:

- nr. 588-2; S=11m²;

- nr. 588-3; S=10m²; /pjesa tjetër trajtohet me PRRH për Blloqet B17, B18, B18 & B20-Lagjja "Mati 1" 2017-2025/

- nr. 588-5; S=44m²;

- nr. 588-6 S=0.00m²;

Trajtuar: S=65m²;

- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesave të kompleksit, të jetë "Zonë me përmbajtje mikse" - banim shumë banesor & afarizëm dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo dhe hapësira garazhesh etj. (sipas projekt propozimit);

- Etazhiteti maksimal për Bllokun urban "B16" të Planit Rregullues "Mati 1", është IV ÷ VII etazhe mbi tokë (sipas projekt propozimit P+7+Ph);
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelave kadastrale të bashkuara / parcelë ndërtimore (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazën - gabarit të përdheses ose suteranit, sipas PZHU-së është max.40%:

Kompleksi me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam."1" ÷ "5";

$S = 6330 \times 0.4 = 2532\text{m}^2$ / sipas PRRU & vendimi/

$S = 2326.24\text{m}^2$ / sipas projekt propozimit /

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore (ISHPN), për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit është max.60%, bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është:

Kompleksi me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam."1" ÷ "5";

$S = 6330 \times 0.6 = 3798\text{m}^2$ / sipas PRRU & vendimit /,

$S = 2427\text{m}^2$ / sipas projekt propozimit /

- Koeficienti i parcelave kadastrale të bashkuara / parcelës ndërtimore, destinuar për hapësira gjelbëruese (ISHPGJ) është min.40%, bazuar në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës me gjelbërim të lartë, të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion:

Kompleksi me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam."1" ÷ "5";

$S = 6330 \times 0.4 = 2532\text{m}^2$ / sipas PRRU & vendimit/e

$S = 2540\text{m}^2$ / sipas projekt propozimit /

- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Rregullues "Mati 1" – PZHU-së është max. 2.6 . Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , 50% për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - **suteren**, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe kjo sipërfaqe është:

Kompleksi me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam."1" ÷ "5";

$S = 6330 \times 2.6 = 16458\text{m}^2$ / sipas PRRU & PZHU-së/

$S = 16627.10\text{m}^2$ / sipas projekt propozimit duke përfshi edhe kompensimin/shpronësimi/

- Me aplikimin e Vendimit 01nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për kompensimin e pronës private planifikuar për interes publik me koeficient të ndërtimit, sipërfaqja e parcelës jashtë vijës rregulluese (deri në 20% të parcelës ndërtimore) mund të kompensohet, dhe sipas kalkulimit kjo sipërfaqe e shprehur në përqindje (%) është $S = 65/6330 \times 100 = 1.02\%$. Sipërfaqja prej $S = 65\text{m}^2$ do të trajtohet, bazuar në vendimin e lartë cekur dhe koeficientit të planit rregullues 2.6 dhe me këtë rast sipërfaqe ndërtimore e kompensuar do të jetë: $S = 65 \times 2.6 = 169\text{m}^2$.

Bazuar në kalkulimet e lartë cekura sipërfaqja totale e lejuar ndërtimore për Lam."4" do të jetë:

$S = 16458 + 169 = 16627\text{m}^2$;

Pjesa mbetur e parcelës kadastrale, nr.588-3 ZK Matiçan, me sipërfaqe $S = 3418\text{m}^2$, do të trajtohet me PRRH për Blloqet B17, B18, B18 & B20-Lagjja "Mati 1" 2017-2025.

- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, protokolluar me numrin 01nr.031-185481 dt. 14.08.2016, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Bazuar në kriteret e planit rregullues, "*sipërfaqja e lirë përreth objektit duhet të pozicionohet në kuadër të "ngastrës"- brenda parcelës kadastrale, dhe për të siguruar dritë dhe ajër të mjaftueshëm*", kjo sipërfaqe e lirë duhet të jetë 0.4 x H (ku H, është lartësia mbi tokë e ndërtesës), për të mundësuar ndriçim direkt të mjaftueshëm natyror, nëpërmjet hapjeve në fasadë për hapësirat e banimit (dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, korridore, etj), dhe kjo sipërfaqe e lirë duhet ti referohet kufirit të parcelës, e cila distancë e njëjtë do të vlejë edhe për hapësirën mes dy ndërtesave të kompleksit;
- Distanca anësore e ndërtesës pa hapje në fasadë apo me hapje të kthinave sekondare dhe komunikimit (banja, wc, depo, shkallë, etj.) të jetë min. 3.0 m. Nëse sigurohet pëlqimi i vërtetuar

nga pronari/pronarët e parcelave fqinje, kjo distancë mund të zvogëlohet apo mund të ndërtohet në kufi të parcelave, por në atë rast nuk lejohet hapje në ato fasada.

- Për të siguruar një front rrugor të lirë në pjesët qendrore, në bërthamat e zonave, parashihet tipi i mbulimit të ngastrës ndërtimore është "d1";
- Ngritja e nivelit të përdheses nga niveli i terrenit të jetë max. 1.20 m;
- Qasja në Kompleksi me ndërtesë shumë banesore & afariste të jetë nga rrugët e planifikuara të planit rregullues urban dhe rrugët e brendshme e bllokut, sipas Plani i situacionit - "zgjidhja urbane";
- Për çdo njësi banesore dhe çdo 30 m² të neto sipërfaqes së afarizmit, të planifikohet një vend parkim, në kuadër të ndërtesave apo kompleksit;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe parkingjet e jashtme, rrugë të brendshme të kompleksit, si dhe shtigjet & trotualet;
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;

V. Kompensimi / shpronësimi me koeficient ndërtimi i pjesës së parcelës: nr.588-2 me S=11m², nr.588-3 me S=10m² dhe nr.588-5 me S=44m², me gjithsej, S=65m², të përfshira në hapësirë publike të planifikuara – rrugë të realizohet si më poshtë:

Sipas kalkulimeve në paragrafin IV., parcela ndërtimore e kompleksit në kuadër të Ngastra e ndërtimit "L", "Bllokut urban "B16" është me sipërfaqe prej S=6330m², andaj bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, kompensimi i pronës private të përfshirë në hapësira me interes publik, mund të realizohet me koeficient të ndërtimit për sipërfaqet deri 20%, dhe sipas kësaj, përqindje(%) e përcaktuar është $S=65 / 6330 \times 100 = 1.02\%$, e cila sipërfaqe mund të kompensohet me koeficient ndërtimi, andaj, pronarët për sipërfaqen e theksuar, mund të kompensohen me sipërfaqe ndërtimore të ndërtesës: S=65 x 2.6 = 169m², kurse pjesa tjetër e parcelës nr.588-3 ZK Matiçan, me sipërfaqe prej S=3418m², do të ndahet/parcelohet dhe do të trajtohet me Plani Rregullues i Hollësishëm për Blloqet, B17, B18, B18 dhe B20-Lagjja "Mati 1" 2017-2025, miratuar me Vendim 01nr.020/01-0142459/17 dt.14.06.2017.

Kjo drejtori përmes këtij paragrafi të vendimit të kushteve ndërtimore jep PËLQIM për kompensimin / shpronësimin me koeficient ndërtimi të pjesës së parcelës kadastrale. Kjo procedurë e kompensimit / shpronësimit me koeficient ndërtimi do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të pronarit të parcelës dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafit, nga pronari & investitori, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesës shumë banesore & afariste, të përcaktuara me këtë vendim të kushteve ndërtimore.

VI. Ndarja/parcelimi i parcelës kadastrale nr.588-2, 588-3 & 588-5 ZK Matiçan, do të realizohet sipas vijës rregulluese me rrugën dhe gjelbërimin e planifikuar të planit rregullues, përcaktuar në Manualin e ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar.

Kjo drejtori përmes këtij paragrafi të vendimit të kushteve ndërtimore jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartcekura, sipas Manualit i ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar. Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronari & investitorit, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori, e i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

Kjo procedurë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës.

VII. Bashkimi i pjesëve dhe parcelave kadastrale, nr.588-2, 588-3, 588-5 & 588-6 ZK Matiçan, sipas parcelës ndërtimore bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" dhe manualit të bashkimit, punuar nga gjeometri i licencuar, do të bëhet në një parcelë ndërtimore.

Andaj kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin e parcelave & pjesëve të parcelave të lartë cekura sipas, Planit të situacionit-“zgjdhja urbane” dhe manualit i bashkimit të parcelave kadastrale. Procedura e bashkimit do të realizohet bazuar në këtë paragraf, e i cili pëlqim do të shërbej si bazë për evidentimin në operetën kadastrale.

Procedura e bashkimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë për Kadastër, sipas këtyre kushteve ndërtimore, me kërkesë të pronarëve & investitorit, duke u bazuar në Plani i situacionit – “zgjdhja urbane” dhe Manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga kompania gjeodezike e licencuar, i cili është pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore.

VIII. Kyçja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR “Prishtina” aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga “Termokos” - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

IX. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, “Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, “Rregullores mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi”, të MMPH nr. 0/2016 dt. 04.11.2016, “Udhëzimit Administrativ MMPH-së 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor”, bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjdhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit , me rrugë, shtigje, mobilian urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;

- *Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;*
- *Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;*

X. Dokumentacioni ndërtimor për Masat e mbrojtëse nga zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e “Deklaratë” për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- *Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;*
- *Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);*
- *Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;*
- *Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;*
- *Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);*
- *Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.*

Dhe për **Leje Mjedisore Komunale** të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- *Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;*
- *Certifikatën për regjistrimin e biznesit;*
- *Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;*

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

XI. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin / investitorin.

Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- *Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);*
- *Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;*
- *Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;*
- *Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);*
- *Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);*
- *Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelave & investitorit);*

XII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcelat kadastrale, nr.588-3, 588-5 & 588-6 ZK Matičan, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, janë të evidentuara me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit “Arë e klasit 3 & 5”, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konformë nenit 11, 13 & 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 & 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelës ndërtimore përcaktuar sipas Plani i situacionit

– “zgjdhja urbane”, dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej $S=6330 - 277 = 6053m^2$. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

XIII. Pagesa e taksës administrative për leje ndërtimi dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të kalkulohet/realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës & tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XIV. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore është një(1) vit, me mundësi të vazhdimit për një(1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

Arsyetim

Kërkuesit / pronarët, Suat Berisha, Ajet, Avdulla dhe Lulzim Krasniqi, Maliq Buzuku nga Prishtina, lagjja ”Mati 1, me kërkesën 05nr.350/02 – 0141344/18 dt.13.06.2018, kanë kërkuar nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e Kompleks me ndërtesë shumë banesore & afariste - Lam.”1” ÷ “5”, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën për kushte ndërtimore dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës, është prezantuar dokumentacioni dhe provat si në vijim:

- *Dëshminë mbi pronësinë për parcelat kadastrale: Kopjet e planit për parcelat kadastrale nr.588-2, 588-3, 588-5 & 588-6; Certifikatat e njësjive kadastrale, P-71914050-00588-2, P-71914050-00588-3, P-71914050-00588-5 & P-71914050-00588-6 ZK Matiçan, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës;*
- *Incizimin gjeodezik të lokacionit, punuar nga gjeodeti i licencuar Ferid Ahmeti nga Prishtina, me numër të licencës nr.174;*
- *“Informim nga Plani Rregullues Mati 1 – PZHU” me referencë 01nr.350/01 – 104228/18 dt.17.05.2018, lëshuar nga Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës;*
- *Vërtetimi i tatimpaguesit Ajet Krasniqi nr.135415/18 dt.06.06.2018;*
- *Vërtetimi i tatimpaguesit Maliq Buzuku nr.138854/18 dt.11.06.2018;*
- *Vërtetimi i tatimpaguesit Lulzim Krasniqi nr.137270/18 dt.07.06.2018;*
- *Vërtetimi i tatimpaguesit Avdulla Krasniqi nr.137283/18 dt.07.06.2018;*
- *Vërtetimi i tatimpaguesit Suat Berisha nr.127049/18 dt.29.05.2018;*
- *Fotokopja e dokumentit të identifikimit, të pronarëve;*
- *Manuali i ndarjes dhe bashkimi të parcelave kadastrale, nr.588-2, 588-3, 588-5, 588-6 ZK Matiçan, punuar nga gjeodeti i licencuar Ferid Ahmeti Prishtina, me numër të licencës nr.174;*
- *Projektin konceptual - “zgjdhja urbane” të kompleksit me projekt ideor të ndërtesave shumë banesore & afariste dhe hapësira të planifikuara, hartuar nga N.T.P.“PRO Joni” nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit 70378781 dhe projektues Fatjon Ibrahim, inxh.dip.ark.;*
- *“Ftesa” e datës 22.08.2018 dërguar Suzana, Flora, Shkurte dhe Liridona Zymeri bashkë pronar të parcelës, nr.587-0 & 585-1 ZK Matiçan;*
- *“Ftesa” e datës 22.08.2018 dërguar Qemail Spahiu pronar i parcelës, nr.585-3 ZK Matiçan;*
- *“Ftesa” e datës 22.08.2018 dërguar Muhamet Vrapqani pronar i parcelës, nr.585-2 ZK Matiçan;*
- *“Procesverbal” i datës 31.08.2018, i mbajtur në zyrat e drejtorisë;*
- *Deklaratë – Pëlqim, të deklaruesve Suat Berisha, Ajet Krasniqi, Lulzim Krasniqi, Maliq Buzuku nga Prishtina vërtetuar te noter Ramadan Bunjaku në Prishtinë, me Nr.rend.7237/2018 dt.07.09.2018.*
- *Fotot e lokacionit.*

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të kërkesës për kushte ndërtimore 05nr.350/02 – 0141344/18 dt.13.06.2018, dokumentacionin e prezantuar me kërkesë dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës administrative, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe procedurës administrative, si dhe dokumentet e planifikimit hapësinor, aktuale - në fuqi, për atë zonën urbane: Planin Rregullues “Mati 1”, miratuar me Vendimin për

ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues "Mati 1" të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01nr.35-642 dt.01.04.2010 dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues "Mati 1" të KK Prishtinë 01 nr. 031-1678 dt. 20.07.2011, Planin Zhvillimor Urban miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës 01nr.035-181427 dt.24.09.2013, dhe Plani Rregullues i Hollësishëm për Blloqet, B17, B18, B18 dhe B20-Lagjja "Mati 1" 2017-2025, miratuar me Vendimin 01nr.020/01 - 0142459/17 dt.14.06.2017, në mënyrë kronologjike konstaton se:

Parcelat kadastrale, nr.588-2, 588-3, 588-5 & 588-6 ZK Matiçan, përfshihen në kuadër të Ngastra e ndërtimit "L", Bllokut urban "L" dhe hapësirë publike – rrugë & gjelbërim të planifikuar e Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, dhe pjesërisht pjesa e parcelës kadastrale nr. 588-3 ZK Matiçan në kuadër të Plani Rregullues i Hollësishëm për Blloqet, B17, B18, B18 dhe B20-Lagjja "Mati 1" 2017-2025, miratuar me Vendimin 01nr.020/01-0142459/17 dt.14.06.2017, ku pjesa ndërtimore e parcelave sipas Planit Rregullues "Mati 1" dhe PZHU-së është e destinuar si zonë "Zonë me përmbajtje mikse", i cili destinim është edhe synim i kërkuësve, bazuar në projekt propozimin e prezantuar.

Me analizën e projekte propozimit të prezantuar për parcelat kadastrale, nr.588-2, 588-3, 588-5 & 588-6 ZK Matiçan, është konstatuar se, parcela ndërtimore formohet nga pjesët e parcelave të lartë cekura me sipërfaqen prej $S=6330m^2$, nga totali i sipërfaqeve të parcelave në bazë të njësive kadastrale, e që është $S=9813m^2$, dhe nga kjo sipërfaqe totale, sipërfaqja prej $S=65m^2$ do të trajtohet me këto kushte ndërtimore, bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, kompensimi i pronës private të përfshirë në hapësira me interes publik, kurse sipërfaqja prej $S=3418m^2$, do të trajtohet me kriteret dhe parametrat e Plani Rregullues i Hollësishëm për Blloqet, B17, B18, B18 dhe B20-Lagjja "Mati 1" 2017-2025,

Bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" e prezantuar, konstatohet se janë respektuar dhe përmbushur parametrat dhe kriteret e planit rregullues, duke marr për bazë edhe gjendjen faktike në terren dëshmuar edhe me incizimit të gjendjes faktike të bllokut urban punuar nga gjeometri i licencuar, andaj pas shqyrtimit të kërkesës dhe duke u bazuar në rregullativën ligjore, konkretisht nenin 18 të Ligjit për ndërtim Nr.04/L -110 dhe UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, me datë 05.07.2018 ka vendosë "Njoftim publik" për njoftimin dhe mundësin e dhënien së komenteve të pronarëve dhe poseduesve të rrethinës në diametrin e dritës prej 50m', i cili njoftim ka qëndruar deri me datë 19.07.2018, gjatë së cilës periudhë nuk kanë arritur komente në email adresat e vendosura në njoftimin publik, që nënkupton se kjo drejtori mund të vazhdoj me procedurat e caktimit të kushteve ndërtimore;

Pas analizë së Planit të situacionit – "zgjidhja urbane" në aspektin e pozicionimit të ndërtesave me distanca të përcaktuara, konstatohet se i njëjti i plotëson (distancën $0.4 \times H$ me hapje primare dhe min.3.0m me hapje sekondare), si dhe duke pas parasysh organizimin e parterit, të kompleksit me rrugë, shtigje dhe hapësira gjelbëruese brenda parcelës ndërtimore;

Me analizën gjithë përfshirëse të Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" në raport me Bllokun urban "B-16" ku shtrihet parcela ndërtimore sipas projekt propozimit, u konstatua se, duhet të njoftohen edhe pronarët e parcelave fqinje, edhe pse të njëjtit janë informuar për synimet e pronarëve të parcelave nr.588-2, 588-3, 588-5 & 588-6 ZK Matiçan, përmes "Njoftim publik", u vendos se edhe njëherë të njëjtit të informohen edhe përmes ftesave zyrtare. Andaj, janë përgatitur dhe dërguar ftesat e datës 22.08.2018, pronarëve dhe bashkë pronarët e parcelave kadastrale, nr.585-2, 585-3, 587-0 & 585-1 ZK Matiçan, që të marrin pjesë në procedimin administrativ me datë 29.08.2018 dhe të informohen dhe deklarohen lidhur me projekt propozimin e prezantuar me kërkesë.

Në datën dhe orën e përcaktuar në ftesë, janë paraqitur vetëm pronarët dhe arkitekti i të cilët kanë parashtruar kërkesë për kushte ndërtimore, si dhe përfaqësuesi i bashkë pronarëve të parcelave nr.587-0 & 585-1 ZK Matiçan, kurse të ftuarit e tjerë nuk janë paraqitur në takim, ku në këtë takim është trajtuar Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" dhe parametrat dhe kriteret e planit rregullues, dhe është arritur pajtimi në mes të pronarëve të parcelave, nr.588-2, 588-3, 588-5 & 588-6 ZK Matiçan dhe përfaqësuesit të bashkë pronarëve të parcelave, nr.587-0 & 585-1 ZK Matiçan, që të planifikohet një rrugë e brendshme e bllokut e cila do të ju shërben dy parcelave ndërtimore me shtrirje proporcionale në dy parcela ndërtimore, dhe Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" edhe me rrugën e propozuar të vërtetohet te organi kompetent, me ç' rast edhe është mbajtur procesverbali,

i cili është pjesë e dosjes. Andaj bazuar në dakordimet e lartë cekura pronarët e parcelave kadastrale nr.588-2, 588-3, 588-5 & 588-6 ZK Matiçan, me Deklaratë – Pëlqim Nr.7237/2018 dt.07.09.2018, përpiluar te noter Ramadan Bunjaku në Prishtinë, janë pajtuar për ndërtimin e rrugës së përbashkët në mes dy komplekseve;

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, është aprovuar zgjidhja e propozuar dhe janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të kompleksit me rrugën e brendshme të bllokut, me rrugën e planit rregullues urban dhe ndër të tjera konstatohet :

Pas shikimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Suat Berisha, Ajet, Avdullah, Lulzim Krasniqi dhe Maliq Buzuku, nga Prishtina, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-0141344/18, të dt. 13.06.2018, kyçja për automjete në rrugën e planifikuar në lagjen "Mati 1", për ndërtesën L1 me etazhitet 2B+P+7+PH, ndërtesën L2 me etazhitet 2B+P+7+PH, lamela L3 me etazhitet 2B+P+6, Lamela L4 me etazhitet 2B+P+7, dhe ndërtesa L5 me etazhitet 2B+P+5+Ph, të prezantuara si në situacion, mund të pranohet si e till. Në fazat e ardhshme të projektimit dhe realizimit të ndërtesave banesore me afarizëm për rampa dhe vend parkime, duhet të aplikohen kriteret sipas "Rregullores për Normat Teknike për Ndërtesat e Banimi në Bashkëpronësi", dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes. Gjerësia e rrugës kaluese me qarkullim dy kahore përgjatë hapësirave të vend parkimeve të jashtme dhe të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m. Ndryshime në rrugë të planifikuar sa i përket regjimit të trafikut me qëllim të favorizimit të ndërtesave banimore afariste nuk duhet të ketë. Kyçja duhet të harmonizohet dhe të përshtatet me profilin e rrugës edhe në kohën kur realizohet ajo.

Pas konstatimeve të lartë shënuara , dokumentacionit të shqyrtuar, rregullativës ligjore në fuqi dhe duke u mbështetur në parimin juridik "Zbatimi i ligjit më të favorshëm", për zbatimin e Vendimit 14nr.350/05 – 0069714/18 dt.22.03.2018,të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, "Për Përcaktimin e Mënyrës së Zbatimit të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor në Zonat Urbane" miratuar në fazën e procedimit administrativ- trajtimit të kërkesës për rishqyrtimin e kërkesës për kushte ndërtimore, është konstatuar se, bazuar në nenin 18 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013 dhe nenin 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", është prezantuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për caktimin e kushteve ndërtimore, dhe "zgjidhja urbane" e propozuar është në harmoni me kriteret e planit rregullues urban, andaj u vendos që me vendim të caktohen Kushtet ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacioni - "zgjidhja urbane" e kompleksit me ndërtesa të planifikuara dhe hapësirat përcjellëse; Situacioni i parcelave kadastrale në raport me rrugët e planifikuara, si dhe vijën ndërtimore & rregulluese nga Plani Rregullues Urban "Mati 1" në sistemin koordinativ KosovaREF 01; Manuali i bashkimit & ndarjes së parcelave kadastrale nr.588-2, 588-3, 588-5 & 588-6 ZK Matiçan

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këto kushte ndërtimore, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtyre kushteve ndërtimore. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dërgohet: Kërkuesve, Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhimin të Kontratave, Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR.350/02 – 0141344/18 DT. 01.10.2018**

Zyrtari:
Ergyn Hajredini



U.D. Udhëheqëse e Sektorit:
Mimoza Berisha Prestreshi



